



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kuvendi i Komunës
Nr.02/ 583
Datë: 31.12.2018

PROCESVERBAL

i mbledhjes së XII-të (e dymbëdhjetë) të rregulltë të Kuvendit Komunal të Malishevës

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë -I- urgjente.
2. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor financiar për vitin 2018 të Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.
3. Informimi nga Drejtoria për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore dhe ndarjes së subvencioneve.
4. Informimi nga Kryetari i Komunës për mbështetjet e familjeve të varfra.
5. Debat për gurëthyesit që veprojnë në Komunën e Malishevës.
6. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/353 datë:18.09.2018 të parashtruar nga "TIMI" Kosova, Drenocfi 5 me pronar Agim Krasniqi nga fshati Drenoc.
7. Shqyrtimi i kërkesës nr.08/424 datë:25.10.2018 e parashtruar nga Agron Krasniqi nga fshati Drenoc.
8. Shqyrtimi i raportit të Kryetarit të Komunës z.Ragip Begaj rreth zbatimit të të gjitha rekomandimeve të dhëna nga zyra kombetare e Auditimit për vitin 2015,2016 dhe 2017.
9. Emërimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin e rrugëve.
10. Informate nga drejtori i Ekoregjionit, njësia në Malishevë për vitin 2018.
11. Informimi nga Drejtoria për Urbanizëm për realizimin e projekteve kapitale 2018.
12. Formimi i Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019.
13. Informimi nga Drejtoria për Inspektorat rreth punës për periudhën Janar-Nëntor 2018.
14. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2019.
15. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/442 datë: 05.11.2018 e parashtruar nga Ramiz X.Thaqi nga fshati Mirushë për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.
16. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/463 datë: 12.11.2018 e parashtruar nga Faik Hoti nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

17. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1668 datë:22.11.2018 për marrjen e vendimit për ndërrimin e pronës publike me pronë private sipas kërkesës së parashtruar nga z.Xhevat Paçarizi nga fshati Dragobil.
18. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1669 datë:22.11.2018 dhe marrja e vendimit në lidhje me shkresën e parashtruar nga kryesia e fshatit Drenoc-lagja Mzeze, për bashkëfinancim të projektit "Ndërtimi i shtëpisë së Komunitetit".
19. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1597 datë:06.11.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për ndërrimin e pronës publike me pronë private për interes publik, me rastin e ndërtimit të objektit të shkollës fillore në fshatin Panorc, KK.Malishevë.
20. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.01/1319 datë: 14.09.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës për iniciimin e procedurave administrative në lidhje me dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës publike me qëllime të ushtrimit të aktiviteteve ekonomike dhe biznese private.
21. Shqyrtimi i kërkesës nr.01/1611 datë:07.11.2018 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, në lidhje me kërkesën nr.01/1264 datë:31.08.2018 nga z.Haxhi Hazrolli nga fshati Banjë, KK.Malishevë.
22. Të ndryshme.

Mbledhja mbahet me datë 05.12.2018 dhe filloi në ora 10:15 Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 24 asambleistë, Kryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së dhe media.

Rrahim Morina: Përshendetje për të gjithë ju të pranishëm! Filimisht ju kërkoj falje për shkak që është shtyrë mbledhja por ishte me kërkesë të Kryetarit Begaj sepse kishte musafirë veteranë të luftës nga Kroacia!

E hapi debatin jashtë rendit të ditës. Urdhëroni kush e do fjalën!

Alban Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Sot me vendim të Presidentit të Republikës së Kosovës z. Thaçi është shpallur ditë zie dhe për nderim të ish-presidentit amerikan Xhorxh Bush kërkoj 1 min heshtje.

Rrahim Morina: Presidenti i 41-të i SHBA-ve ka qenë njeriu i parë që ja ka treguar vijen e kuqe Serbisë e që është përcjellur edhe te presidentët tjerë prandaj kërkoj 1 min heshtje në emër të Kuvendit për nderuar veprën e tij!

Lavdi!

Kalojmë në debatin jashtë rendit të ditës.

Hidajete Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Ne para ca ditësh kemi mbajtur një takim në fshatin Carrallukë për dëgjime publike për projekt-buxhetin që nuk marrin pjesë gartë. KDI ka paraparë që në të gjitha komunat e Kosovës të përzgjidhet një fshat për hartimin e projekt-buxhetit dhe problemet, shqetësimet që atakohen ato. Ne me KDI-në dhe Zyrën për Barazi

Gjinore kemi zgjedhur fshatin Carrallukë për takime me gratë. Në atë takim e pamë brengat dhe hallet të cilat i kanë nëoër shtëpitë e tyre, në shkollë si dhe për rrugët. Një ndër problemet që u paraqiten aty ishte për shkollën "Imer Krasniqi" për aneksin që Kryetari ju kishte premtuar për shkollën e vjetër që janë duke e vijuar mësimin 6 klasë që nuk mund të mbajnë mësimin në kohën e dimrit sepse oxhaqet janë të vjetra, drtiaret e prishura etj.

Gjithaashtu probleme me nxemje kishte edhe në shkollën fillore "Hilmi Hoti" në Carrallukë dhe një shkollë në Drenoc. Përse këto nxemje nuk funksionojnë?

Problemi tjetër në Carrallukë është edhe uji i pishëm gjë të cilën e ka ngritur më heret edhe Ilazi. Si mundet të funksionojë një shkollë pa ujë të pishëm dhe banorët e këtij fshati?

Fshati Carrallukë nuk ka transport. Unë e kam ngritur edhe më heret çështjen e transportit urban që Malisheva ka nevojë që lidhen fshatrat përreth si Mirusha, Carralluka, Banja dhe Dragobili.

Arbëreshë Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Duke e pasur parasysh rrjedhjen e punës së Kuvendit dhe duke e parë në kohët e fundit që Kuvendi i Komunës së Malishevës është pjesë e punëve të kundërligjshme dua të ngris shqetësimin që ky Kuvend po vazhdon pa ndalur të bëjë shkelje ligjore. Kuvendi Komunal i Malishevës po vazhdon kundërligjshëm të mbaj takimet e KPF-së e që ishte temë edhe nëpër media. Kundërligjshëm u bë temë edhe ky Kuvend me çështjen e buxhetit, kundërligjshëm u bë me vendimet të cilat nuk kanë baza ligjore siç është ai i fundit i marrur për drejtorët e shkollave.

I nderuar Kryesues, nuk dua të jem pjesë e punimve të Kuvendit Komunal ku në vazhdimësi ka shkelje ligjore. Kështu që ju lutem juve si Kryesues, të gjithë asambleistëve që po bien pre e politikave të gabuara e që populli i Malishevës nuk ndihet mirë kur merren vendime të kundërligjshme e të bëhet temë diskutimi nëpër të gjitha emisionet televizive. Prandaj ju lutem që të mos vazhdohet me veprime të tilla!

Rrahim Morina: Çështjen e KPF-së MAPL-ja e ka çuar në gjykatë atëherë të presim vendim e saj dhe ne do ta respektojmë atë. Ndërsa për buxhetin shkelje ka bërë Kryetari e jo Kuvendi këtë e dimë të gjithë dhe janë shkresat zyrtare. Ndërsa vendimi për drejtorët sipas MAPL-së është dashur të bëhet në formë të rekomandimeve.

Arbëreshë Krasniqi: Ne e dimë se çka po dëgjojmë e kuptojmë dhe e marrim vesh se çka po thuhet. Çështja e buxhetit është kryekëputë e inicuar me problematika nga ana e juaj dhe e mbështetur nga pjesa e opozitës me buxhetin alternativ.

Sa i përket KPF-së ne do të ngrisim padi për shkeljet ligjore që po bëhen aty dhe me mosplotësimin e anëtarëve të NISMA aty.

Nebih Bibaj: Përshëndetje për të gjithë! Çështja e parë për të cilën do të flasë tani është sinjalizimi i rrugëve e konkretisht në fshatrat si Senik te rruga e devijuar për autostradën. Aty kemi pasur një rast me fatalitet sigurisht në mungesë të sinjalistikës. Drejtor, a je dalur në terren që të shohësh gjendjen dhe problemet që janë nëpër rrugë e që mungojnë edhe pasqyrat?

Rasti tjetër është në Lladroc te kryqi ku duhet urgjentisht të vendoset një pasqyrë aty dhe kur të leshohemi të poshtë nga reka duhet të ketë diku 150m mbrojtës anësor. Këto janë shqetësuese.

Çështja e dytë është për vendpëritjet nëpër staciona të autobusëve si te rasti në Carrallukë ngë kryqin e rrugës sonbë nuk ka vendndalje për autobusë, ata ndalen në rrugë. Këso raste janë të shpështa ku vendi për pritjen e autobusëve është por jo edhe vendndalja për ta. Duhet që të rregullohet kjo sepse po paraqesin rrezik në komunikacion.

Ilaz Krasniqi: Përshendetje për të gjithë! Kryetar, është një kërkesë që u është drejtuar juve nga Komiteti për Familje të Dëshmorëve dhe kategoritë e dalura nga lufta për ndarjen e një parcele 5 ari që t'ju jepet shoqiatave të dalura nga lufta për ndërtimin e një objekti. Kryetar a e keni shqyrtuar këtë kërkesë sepse nuk kemi marrur përgjigje për këtë kërkesë?

Leonitë Kastrati: Përshendetje për të gjithë! Në "Qendren e Kompetencës" ju kanë kërkuar të holla nxënësve për blerjen e topave. Në rastet e mos sjelljeve të parave nxënësit janë dënuar me aktivitete në orën e Edukatës Fizike. Kërkoj nga Kryetari dhe drejtori i Arsimit që të merren më këtë çështje sepse fondet janë të ndara nga Kuvendi Komunal edhe për këto mjete. Falemnderit!

Alban Krasniqi: Nuk është e vërtetë që Angjensionin është përgjegjës për çdo gjë që ndodh në "Qendren e Kompetencës" kështu që merruni me çështjen që ngriti kolegja sepse disa të drejta i ka edhe komuna sepse e ka përgjegjësi arsimin e mesëm. Ne i dimë disa çështje dhe kemi lexuar besa shumë e më shumë se sa disa që janë edhe zv. Ministëra e që na shesin këtu moral politik. Avdi. Arbëreshë dhe krejt juve urime Liberalizimi i Vizave pa dallim për gjithë ata që kanë kontribuar që kjo të ndodhë dhe uroj të mos vazhdoj kështu më sepse nuk ju fal më ky vend! Çëshjet që përmendi zv. Ministria, e para kjo nuk është këtu shumicën e kohës sepse po merret me punë më të mëdha. Ajo duhet t'na tregoj neve se sa ministra i ka Qeverisja Haradinaj dhe a ke respektuar ligjin ai? Këta bëjnë hile edhe me ligjin se duan ta rrespektojnë ligjin tek Asambleja, kur Kryetari Begaj e bënë 50 me 50 i pari do të jap dorëheqje prej KPF-së atëherë të lutem mos u bëjë e padurshme e mos moralizo këtu e mos e bënë drejtësinë veç kur ju konveon! Vendimi për çështjen e drjtorëve është e turpshme atë që the Arbëreshë. Përmbytja e vendimit është 100% e saktë përveç titullit.

E kam këtu një vendim të Kryetarit i dt. 29.10.2018 një aktvendim që Kryetari e ka marrur të drejtën pa e pasur me ligj që të bëjë lëvizjen e projekteve dhe pagesat e tyre nga programi të nënprogrami, nga projekti në projekt nga dt. 26.10.2018 – 31.12.2018. E di që Kryetari nuk ka të drejtë që të merr këtë vendim dhe ka bërë shkelje flagrante. Autoriteti i vetëm për të marrë një vendim të tillë është Kuvendi i Komunës.

Kryesues, kërkujnë nga ana e juaj që vendimet e tilla të shkojnë në MAPL dhe në Ministrinë e Financave që të marrim një përgjigje nga ato për ligjshmërinë e tij në mënyrë që ta kemi rrugën e hapur për organet e drejtësisë.

Arbëreshë Krasniqi: Alban, nëse do të përgjigjem edhe si Zv.Ministre. MTI ka marrë vendim që nga tregu në nivel vendi lodrat kancerogjene. Kjo Ministri për herë të parë po tregon që ne e duam vendin dhe ka marrë masën 100% për produktet serbe e këto janë vendime historike. Ne e dimë që shumë më pak se unë rri në Malishevë Alban Krasniqi gruaja e tij dhe fëmijët e tij. unë jetoj në Lubizhdë dhe punoj në Prishtinë. Unë asnjëherë nuk jam gjendur në keqpërdorime dhe asnjëherë nuk do të gjendem!

Kastriot Berisha: Mbase kaluat prej Asamblesë në Parlament është më të vërtetë për të ardhur keq! Nuk ka nevojë zv.ministria t'na tregoj gjërat këtu e as Albani sepse është vendi ku duhet të tregohen sepse ne këtu jemi që të debatojmë për çështjet komunale që duhet t'i trajtojë Asambleja, nuk është Parlament.

Arbreshë, shkolla fillore "Ibrahim Mazreku" i ka të dëmtuara dërrasat e zeza prandaj është më e rrugës që të diskutohen çështje të tilla ashtu siç ne kemi rekomanduar shkarkimin e atyre drejtorëve.

Ali Morina: Përshendetje për të gjithë! Shqetësimi im është që pas publikimit të tenderit për shkollat fillore për kalldaja dhe paisje tjera. Paisjet për nxemje është dashur të kryhen para sezonës dimërore tash është vonë sepse është shumë ftohtë dhe paramendoni nxënësit në shkolla. Shqetësuese është për shkollën në Carrallukë sepse një tender i tillë është shpallur edhe në vitin e kaluar dhe përsëri në këtë vit nuk funksionon pra mjetet monetare ndahen por problemet mbeten të pazgjidhura.

Kërkoj nga drejtori i Arsimit që mbrenda kësaj seance të sjellë këtu kërkesat e drejtorëve për nevojat për shkolla konkretisht për shkollat që është shpallur ky tender. Ne do të merremi me këtë çështje dhe do të verifikojmë se si është gjendja në këto shkolla dhe pas paisjeve që kërkohen dhe realizimit të tenderit do të dalim përsëri që të verifikojmë se a janë realizuar kërkesat sipas shpalljes së tenderit.

Halil Morina: Përshendetje për të gjithë! Kastrioti e akuzoj Arbreshën që hapi tema përtej kësaj që na takon, atëherë edhe unë po e akuzoj Albanin sepse ai hapi këso tema përtej kompetencave tona siç ishte çështja e liberalizimit të vizave. Nuk e di pse Albani na akuzoi neve e po e përjashton vetën. Fajtor për këtë gjendje në Kosovë është i madh e i vogël, kush më shumë e kush më pak.

Problemi Alban te subjekti i juaj është i bazuar mbi esktrimizmin politik. Subjekti juaj mendon që e ka kapur të vërtetën në dorë e gjithëçka jashtë juve mendoni që janë të pavërteta e dallavere prandaj na akuzon ne.

Rrahim Morina: Ju lutem debaton për shqetësimet që kanë të bëjnë me problemet e qytetarëve mos debaton për çështje tjera që nuk na përkasin.

Sylë Dukolli: Përshendetje për të gjithë! Nuk më pëlqeu debati i Albanit e as i Arbëreshës sepse mbi të gjitha disa respektet duhet t'i ruajmë dhe të komunikojmë njerzisht.

Dua t'i ngris dy çështje për fshatin tim dhe i drejtohem Drejtorisë së Urbanizimit se ku ka mbet projektet i Urës? Para 2 javësh patën thënë që fillon mbrenda pak ditësh.

E dyta, ku është projekti për kanalizimin që ka filluar në fshatin tim që të bëhet dhe deri ku ka shkuar ky projekt?

Filloreta Bytyqi: Përshendetje për të gjithë! I nderuar Kryesues, mos lejoni fyemje në aspektin gjinor! Jemi shkolluar për të pasur një detyrë dhe kemi arritur që të kemi detyra me nder. Njësoj është sikur të shani Arbëreshën, sikur mua apo çfarë do femër tjetër.

Alban, këtu nuk lejojmë që t'na fyeni e të shpifni për ne këtu! Mos na shitini moral këtu!

Rrahim Morina: Herave tjera nuk do ta lejojë një debat të tillë dhe nuk do të lejojë fyrie dhe keqpërdorim të foltores këtu.

Dola këtu që të paraqesë një shqetësim timin për Hidroregjionin. E kam parë që një marrëveshje ekziston në mes të Kryetarit dhe Hidroregjionit. Në faturë të Hidroregjionit qytetarëve ju faturohet edhe kanalizimi nga 2€ në muaj. Në realitet ka qytetarë që nuk kanë as ujësjellës se leje

më kanalizim. Unë propozoj që kjo marrëveshje të anulohet për shkak që aty faturohet edhe kanalizimi ku kontrata ishte për shkolla por kjo është e dëmshme edhe për qytetarët. Ka raste kur ujësjellësi nuk ja ka çuar ujin qytetarëve ndërsa ju dërgon faturen. Ata që kanë ujësjellës në rregull le të faturohet por jo edhe ata që s'kanë ujë e që ju dërgohen faturat.

Alban Krasniqi: Këtu qëllimisht që sa herë përmendet familja ime sikur të ishte familja e kryetarit të tyre historinë e së cilës ne e dimë mirë. Unë nuk jam idhatrë i mbrojtjes nën gëzhgojnë e familjes dhe në as në emrin e asnjërit anëtarë të saj. Thirrrem në emrin tim, në emër të drejtës, të ligjit dhe të drjtave që më takojnë.

Pa marrë parasysh gjininë për mua e ultë moralisht është lundrimi nëpër politikë, e ultë moralisht është ngritja nëpër pozicione dhe e ultë moralisht është me përdorë gjininë dhe me shkel gjininë. Gjendja në Malishevë na tregon se si jemi dhe e përfaqësojmë gjininë. Ne dimë edhe shumë të vërteta tjera por nuk janë për t'u thënë këtu për secilin e dini edhe ju.

Valon Krasniqi: Përshëndetje për të gjithë! Ne nuk duhet të ofendohemi kolegët njëri me tjetrin. Kam një shqetësim të një zyrtari të komnës sonë që vetëm për një prerje të një shiriti të prorurimit të një shtëpie shkojmë një ekip të drejtorëve dhe Kryetarit. Ato familje kanë fëmijë dhe nëse shihen në trasmetime live nga moshatrët e tyre me të vërtë do t'ju vinte keq. Mendoj që kjo ndikon negativisht në rritjen e tyre. Kërkoj që tani e tutje kur të bëhen të mirat, ndërtohen shtëpi është mirë që mos të shkojnë një ekip prej 20-30 vetash në prerjen e një shëriti.

Arlind Morina: Përshëndetje të nderuar! Kryesues duhet ta respektosh minutazhen e debatit jashtë rendit të ditës prej 30 minuta. Tani ka kaluar më shumë se 1 orë e ne ende nuk e kemi përfundar.

Ka një vit prej marrjes së mandatit të asamblestit në këtë Kuvend po shoh vetëm ofendime, sharje dhe fyrije.

Kam një shqetësim për nënkalimet që janë nëpër fshatra siç është ai në Astrazup që janë në gjendje të keqe. Kryetar, nga kuhs duhen të mirëmbahen ata?

Kastriot Berisha: Arlind, ne ngritem çështje për shkolla dhe tjera më rëndësi e që janë në interes për qytetarët.

Shqetësimi tjetër i imi është sepse e nxjerra një certifikatë të lindjes për dalin dhe për një kopje të letërnjoftimit u desht që të shkoj në zyre, sepse komuna s'ka fotokopje. Unë nuk e di ku po shkon buxheti i ndarë për këto?!

Kryetari-Ragip Begaj: Të nderuar të pranishëm, përshëndetje për të gjithë! do të bëjë përpjekje që t'ju përgjigjem të gjithëve. Është mirë që ne të bashkëpunojmë në mes veti për interesin e qytetarëve sepse kur i harmonizojmë gjërat mund të mbërrijmë një përfundim të mirë.

Është normale që të kemi defekte nëpër disa shkolla prej 40 dhe do të doja që drejtori i Arsimit të përgjigjet për çështjen e shkollave.

Ne Malisheva kemi problem për ujin e pijshëm edhe pse jemi duke punuar shumë në atë drejtim sepse është një projekt në përfundim e sipër për 12 fshatra. Kur do të përfundoj projektin sigurisht që do t'ju informoj.

Alban, edhe nëse e kam marrë një vendim për bartjen e mejteve të buxhetit e kam bërë për të mirën e Malishevës jo për shtëpinë time. Është e vështirë për t'më besuar hajni që unë nuk

vjedhi. Ne i kemi transferuar ato mbetjet e projekteve që mjetet të mos shkojnë suficit por për të mirën e Malishevës.

Nebih, kërkesa juaj ishte me vend por ngadalë ngadalë do të mbërrijmë deri aty. Aty ku është e mundeshme do ta rregullojmë çështjen e pasyrave nëpër udhëkryqe.

Ilaz, ato kërkesa janë adresuar për te unë, unë jam i gatëshëm që t'i bie këtu dhe e ndajmë një parcelë për veteranët aty ku juve ju meritja mendja.

Rrahim, sa i përketë marrëveshjes me Hidroregjionin edhe çmimin edhe rregullat i cakton niveli qendror. Ne nuk e menaxhojmë Hidroregjionin dhe nuk i caktojmë tarifat.

Ne i kemi ndërtuar disa nënkalime me kërkesën e fshatrave për të shmangur rrezikshmërinë e fëmijëve por nuk kemi as kompani dhe as njerëz të autorizuar për mirëmbajtjen e tyre. Është mirë që fshatrat të organizohen dhe të mirëmbajnë nënkalimet.

Kastriot, ka fotokopje por ndoshta ti ke qëlluar pikërisht kur ajo mund të ketë defekt, sepse ajo bënë mijëra kopje ndoshta edhe mbrenda ditës.

Është mirë që të mos të punojmë në baza të inatit. Unë i kam proceduar kërkesat për Asamble por ju i keni kthyer mbrapshtë. Kërkoj që t'i trajtoheni çështjet sepse nuk janë të NISMA por të qytetarëve të Malishevës.

Blerim Thaçi: Përshëndetje për të gjithë! Komuna jonë i ka 43 objekte shkollore dhe 18 prej tyre e mbajnë mësimin vetëm në një ndërrim, ndërsa të tjerat në dy ndërrime. Shkolla e Carrallukës që përmendi profesoresha mund të mbajnë mësimin në dy ndërrime vetëm në shkollën e re.

Çështja e kalldajave do të rregullohet mbrenda kësaj jave. Në kuadër të paramasave që ka bërë Drejtoria e Urbanizimit janë edhe çështjet e radiatorëve e paisjeve tjera. Pra është një kontratë edhe për vitin e ardhshëm deri sa të përfundojë sezona dimërore. Momentalisht të gjitha shkollat janë në funksion dhe kanë nxemje pavarësisht ndonjë defekti të vogël.

Kastriot, nuk na ka ardhur ky shqetësim i tabelave të shkrimit nëpër shkolla sepse ne kemi operatorë i cili ka sanuar dhe ka ngjyrosur tabelat dhe mbrenda javës mund të rregullohet kjo.

Rrahim Morina: Falemnderit për debatin e stërzgjatur sot! Atëherë kalojmë në debat për rendin e ditës. Materialin e keni marrë me kohë. Është një kërkesë e Milazim Dukollit për ndërrim destinim që KPF-ja ka kërkuar sqarim dhe Drejtoria e Kadastrës e ka sjellë sqarimin dhe kërkoj që kjo kërkesë të hyjë në rendin e ditës për sot. E hapi debatin për rendin e ditës.

Ali Morina: Ne grupi ynë kërkojmë që pikat 17, 18, 19, 20 dhe 21 të hiqen nga rendi i ditës sepse nuk kanë kaluar nëpër KPF. Ndërsa për pikën e 19-të në mbledhjen e kaluar është kërkuar këtu që të silllet dokumenti shtesë, letërnjoftimi i pronarit të parcelës ndërsa ai dokument sot nuk ka ardh prandaj kërkuam që të largohet nga rendi i ditës.

Alban Krasniqi: Ne mbledhjen e kaluar të KPF-së nuk janë sjellur dokumentet që janë kërkuar dhe zakonisht kërkesat e Kryetarit vien më mangësi të mëdha siç është kërkesa për shkollën e Panorcit. Aty ka një problem që nuk është kryer çështja e pronësisë pavarësisht që kanë filluar punimet. Kjo është shkelje e rëndë që e ka bërë Kryetari e sot na bie neve që ta trajtojmë pa i plotësuar dokumentet. Respektoj procedurat dhe ligjet Kryetar kur sjellë kërkesa! Pajtohem që pikat që përmendi Aliu të shtyhen për arsyet që përmendem.

Arbëreshë Krasniqi: Ne kërkojmë që të gjitha kërkesat të cilat janë në rendin e ditës të diskutohen e a janë për a kundër le të vendos Asambleja. Ne jemi që në tërsi rendi i ditës të votohet pa dallim dhe të trajtohen të gjitha pikat e rendit të ditës.

Rrahim Morina: Nëse nuk ka debat për rendin e ditës atëherë shkojmë në votim. Kemi dy propozime.

Propozim i parë është nga PDK-ja dhe i përkrahur nga VV që pikat e rendit të ditës 17, 18, 19, 20 dhe 21 të hiqen nga rendi i ditës. Kush është për?

Për: 15

Kundër: 11

Abstenim: 0

Me këtë votim largohen nga rendi i ditës pikat 17, 18, 19, 20 dhe 21.

Propozimi i dytë është nga unë që të futet në rendin e ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesë nr.02/446 i dt: 05.11.2018 e parashruar nga Milazim Dukolli nga fshati Bubavec për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. (Sylë Dukolli del nga salla dhe nuk merr pjesë në votim për çështje konflikt interesi) Kush është për që të hyjë në rendin e ditës?

Për: 25 unanimisht

Me këtë votim futet kjo kërkesë në rendin e ditës.

Kalojmë në votim për rendin e ditës me plotësime dhe ndryshime. Kush është për për rendin e ditës?

Për: 15

Kundër: 1

Abstenim: 10

Me këtë votim aprovohet rendi i ditës.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së parë -I- urgjente. E hapi debatin.

Luan Kryeziu: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket procesverbaleve nuk e di pse sot ka ardhur në shqyrtimi ky procesverbal i I-rë i mbledhjeve urgjente kur në mbledhjet e kaluara kanë ardh i 2, apo i 3-të? Falemnderit!

Rrahim Morina: Mbase s'ka debatues të tjerë, kush është pto aprovimit të procesverbalit të mbledhjes së parë -I- urgjente?

Për: 16

Kundër: 0

Abstenim: 10

Me këtë votim aprovohet procesverabli i përmendur. Shkojmë në pauzën e drekës shihemi në ora 13:30.

Pas pushimit të drekës sipas radhës kalojmë në pikën.

Filloreta Bytyqi: E di që kemi filluar me rendin e ditës po kërkoj që mundësisht pika për gurëthyesin në Kërvasiri të diskutohet në fillim pasi qytetarët janë të pranishëm dhe kjo pikë është shumë e rëndësishme. Kërkoj përkrahjen e juaj Kryesues dhe të gjithë asambleistëve.

Rrahim Morina: Filloreta kërkoj që si pikë e dytë e rendit të ditës të diskutohet për gurthyesit e që sipas renditjes është si pika e 5-të. Kush është për që pika e 5-të kaloj për diskutim si pika e 2-të?

Për: unanimisht

Atëherë më këtë votim unanim pika e 5-të kalon si pika 2 dhe e 2-ta kalon me nr. 5. Jemi pra në pikën e 2-të të rendit të ditës: Debat për gurthyesit që veprojnë në Komunën e Malishevës. E hapi debatin për këtë pikë. Kërkoj një sqarim nga Kryetari ose Muharremi se cilat janë procedurat ligjore deri te dhënia e pëlqimit për një gurthyes.

Alban Krasniqi: Sot ne i kemi ky kërkesa dhe peticione të qytetarëve të fshatit Kërvasari dhe Astrazup dhe nga natyra e problemit janë të ngjajshme.

Mendoj që qytetarët e Kërvasarisë kanë vepruar drejtë me formën e protestës para komunës me kërkesa të qarat që jeta e qytetarëve të vihet në rend të parë. Më bëri përshtypje në këtë protestë që Kryetari pikën kryesore e kishte drejtuar ndaj pjesëmarrjes së fëmijëve në protestë. Kryetar ata fëmijë kishin ardhur me prindër sepse nuk ka mësim më të vleshëm se sa për ta parë rëndësinë e protestës se çka d.m.th shkelja e drejtave e lidhet direkt me jetën e tyre.

Si qytetarë edhe unë jam i prekur nga këta gurthyes dhe do të kundërshtoj funksionimin kaq të egër të këtyre gurthyesëve që po dëmtojnë mjedisin dhe po shaktërrojnë fshatra në emër të fitimit. Rasti i Astrazupit është rasti më flagrant se çka mund të bëjë privati. Unë nuk jam kundër kompanive private por të funksionojnë sipas ligjit dhe të mos cenojnë të drejtat e qytetarëve.

Lidhur më dhënien e pëlqimit për gurthyesin në Kërvasari e di që Kryetari nuk ka për të dhënë përgjigjie, madje as zyrtar ligjor sepse është e qartë sepse proceduralisht pëlqime të tilla nuk mund të jep as drejtori e as Kryetari pa e dhënë paraprakisht Kuvendi Komunal sepse kjo është e ngjajshme sikur kur ndërrohet ndërrim destinimi i tokës bujqësore në atë ndërtimore. Kjo është ndërhyrje flagrante në përgjegjësinë që kemi ne dhe në mbrojtjen e mjedisit që e kemi përgjegjësi ne.

I kam dy propozime. Propozimi i parë është që Kuvendi Komunal të nyjerrë një vendim përmes të cilit nga sot e tutje që të gjitha vendimet në lidhje me dhënien e një leje paraprake se a duhet të hapet një gurthyes a jo vendim duhet ta marrë Kuvendi. Ne duhet që me anë të një Komiteti bashkë me drejtorinë e Urbanizmit të nxjerret një rregull i caktuar ku përcaktohen më pastaj autorizimet se kush i jep.

Propozimi i dytë është me dy alternativa: që Kryetari duhet që t'i shfuqizojë pëlqimet e tij për gurthyes, dhe alternativa tjetër është që për dy rastet veç e veç si për Kërvasari dhe Astrazupit të merr vendim Kuvendi që të shfuqizohen të gjitha pëlqimet të marrua deri me tani për gurthyes.

Arbëreshë Krasniqi: Përshendetje për qytetarët e pranishëm! Të nderuar qytetarë me shumë mirëkuptim e kemi pritur reagimin e juaj dhe ne e kemi diskutuar shumë edhe me Kryetarin Begaj për këtë çështje. Ne jemi për qytetarët dhe me qytetarët dhe nuk pajtohemi që të dëmtohen ata.

Gurthyesi në Astrazup për mua as 24 orë nuk do të operonte aty dhe për qëndrimin tonë si grup. Nëse flasim sipas ligjit atëherë ka kohë për debat dhe mundësi për të ardhur për një përfundim. Këto janë vendime të Agjensionit, vendime të ministrisë, por nëse ka dëmtime për qytetarët siç është rasti me Astrazupin ne duhet të bëhemi të gjithë bashkë dhe t'i drejtohem gjykatave dhe organeve kompetente dhe të kërkojmë që duke u mbështetur në ligje që t'ju ndalohej puna atyre gurthyesve në Astrazup dhe pse jo edhe në Kërvasari.

Nëse një operator i Drenicës vie dhe punon dhe merr miliona duke gërmuar në Komunën e Malishevës e duke bërë dëme në të gjitha nivelet atëherë mos t'i bëhet e padrejtë qytetarit. Atëherë ja nisim prej gurthyeseve në Astrazup e pastaj te krejt gurthyesit që operojnë në K.e Malishevës. Pra unë kërkoj që të bëhemi të gjithë bashkë e të i dalojmë të gjithë.

Halil Morina: Që shumë vite fshati Astrazup është duke vuajtur nga gurthyesit e që janë më shumë se 10 e të cilët veprojnë në mënyrë të paligjshme. Dëmi që shkaktohet nga gurthyesit është i shumëanshëm që nga njerëzit, çarjen e shtëpive, dëmtim të damarëve të ujit, ambienti e deri te shaktërrimi i pyejeve.

Unë kërkoj nga Kryetari i Komunës që të bëjë presion te ato biznese në qoftëse nuk i plotësojnë kriteret dhe nuk respektojnë ligjin dhe t'ju tërheqet leja për punë nga ana e Komunës e më çështjet tjera le të merret ministria.

Ne si fshat jemi të pafuqishëm që të marrim masa vet. Në qoftëse nuk merr masa Komuna dhe Ministria ne do të përpiqemi me aq sa forcë që kemi që ta ndalojmë që mos të shkatërrohet vendbanimi ynë nga këto veprimtari.

Filloretë Bytyqi: Ne si fshat po kërkojmë që mos të biem pre e gurthyeseve sikur Astrazupi. Ne grupi ynë dje e kemi diskutuar me Kryetarin këtë çështje dhe kemi përkrahjen e tij. të vetëm pasuri fshati ynë e ka atë mbulesë të gjelbër dhe të mos shkatërrohet edhe ajo sepse pasojat janë të rënda shëndetsore.

I nderuari Kryetar, edhe si grup edhe si qytetarë jemi që të ndalet veprimtaria e gjithë gurthyeseve sepse dëmet janë të mëdha.

Të nderuar bashkëfshatarë, ju premtoj që në çdo formë do të jem me ju dhe keni përkrahjen time për largimin e atij operatori nga aty.

Ali Morina: Çështja e gurthyeseve është e ndjeshme sepse banorët e Astrazubit kanë rënë pre e e qeversjes komunale dhe asaj qendrore sepse ata nuk e kanë ngritur zërin duke besuar në ato institucione atëherë.

Pas gjithë atyre reagimeve publike të qytetrëve të Astrazubit, ku janë veprimet e institucionve komunale? A ka dalur Inspektoriati ndonjëherë në terren e të shohin që a i plotësojnë kriteret që janë të parapara me ligj? A ka një raport Inspektoriati i Malishevës për shqetësimin e banorëve të fshatit Astrazub? Kryetar nëse nuk do të ketë masa nga Inspektoriati të njëjtat veprime sikur Kërvasari do t'i bëjmë edhe ne. Do të dalim me fëmijë e të rritur e të kërkojmë të drejtat tona.

Rrahim Morina: Përsëritet për qytetarët e fshatit Kërvasari! Komuna e Malishevës e ka për detyrë që t'i mbroj qytetarët nga çdo rrezik madje edhe nga gurthyesit. Ne e dimë që pa e dhënë pëlqimin K. e Malishevës licencën nuk e jep Ministria pra përgjegjësia bie mbi Komunën. Për këtë çështje unë kam diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar.

Mbështetja për ne nga Kryetari është kur ai e tërëheq pëlqimin për të gjithë ata që nuk i plotësojnë kriteret. Unë tri here e kam ngritur këtë çështje në Kuvend dhe asnjëherë as një hap më i vogël nuk është marrë me këtë çështje dhe as që ka për t'u marrur.

Kërkoj që të pezullohen pëlqimet nga Kuvendi Komunal deri në plotësimin e kriterëve për gurthyes.

Alban Krasniqi: Aktualisht zyrtari nuk po mund të qaset në facebook e Komunës, kjo i bie që dikush po përpiket që gjërat mos të trasmetohen dhe është me të vërtetë shqetësuese.

Rrahim Morina: Vazhdojmë me mbledhjen, procesverbali po mbahet dhe nuk guxon të mungojë asnjë fjalë.

Nebih Bibaj: Po ndalem për dy pëlqimet, atij për Mifail Elshanin nga Ngucati që i është anual dhe atë të drejtorit të Urbanizmit për gurthyesin në Kërvasari që ja keni lëshuar. Ja ku i ke Kryetar udhëro.

Po i lexoj disa nga kritetet që i ka përcaktuar Ministria e Mjedisit për gurthyes. Në përputhje me ligjin nr. 03L/214 për vlerësimin e mjedisit neni 20 është: mbahet debat publik dhe me këtë rast Ministria e Mjedisit ju jep pëlqim mjedisor atyre, gjatë shfrytëzimit të respektohen rregullat që janë të përshkruara në projekt kryesor të xehtarisë për shfrytëzimin e gurit gelqeror. Gjatë punës së procesit teknologjik duhen të ndërmerren të gjitha masat për evitimin e ndotjes së mjedisit nga mbeturinat e ngurta, evitimin nga derdhja e vajërave të makinave, evitimin nga derdhja e karburanteve. Gjatë furnizimit me karburantë të makinave të vendoset sistemi gypor për sjelljen e ujit, të stabilimentit të thërmimit të sepemimit ku lirohet pluhëri me qëllim të zvogëlimin të sasisë së pluhërit. Të bëhet furnizimi i rregullt me ujë që përdoret për zvogëlimin e pluhërit përmes gypave që do të vendosen në stabilimente. Nëse nuk bëhet zvogëlimi i pluhërit në vend të duhur aplikanti duhet të vendos stabilimente tjera depluhëruese etj.

Nëse të gjitha këto kushte nuk i plotëson një gurthyes kërkoj që t'u hiqet pëlqimi nga Kuvendi Komunal dhe në të njëjtën kohë të kërkohet nga niveli qendror që t'u hiqen lejet e punës.

Luan Kryeziu: Më të vërtetë është shqetësuese sepse hapat është dashur të merren me kohë atëherë kur kanë filluar gurthyesit në Astrazub dhe të ndalohet kjo dukuri negative dhe e dëshme për qytetarët.

Nuk është mirë që vetëm kur ka delegacione ose qytetarë të pranishëm në Asamble që të mundohemi që t'ju përshtatemi kërkesave të tyre në aspektin formal ndërsa në praktikë shpeshherë marrim vendime tjera e që janë të dëshme për qytetarët.

Shqetësuese për mua është çështja e kompetencave. Ndoshta ne mund të marrim një vendim këtu për ndalimin e punës së gurthyesëve, por sa i fuqishëm është ai vendim? Pra, ne duhet të diskutojmë që a jemi ne kompetentë për ta ndryshuar këtë gjendje? Nëse ne jemi kompetentë unë i pari jam pro.

Duke ju referuar ligjit për mjedisin që ka të bëjë me çështjen e pëlqimit, të lejes dhe nuk është mirë që të paraqesim çështje që janë politike këtu. Në qoftëse operatorëve ju ka lejuar ligjit që të veprojnë ne atëherë nuk mund të bëjmë asgjë.

Sipas Ligjit 03L/025 thotë neni 10, paragrafi 1: asnjë insitucion nuk mund ta lëshoj leje për shfrytëzimin e resurseve natyrore pa pëlqimin mjedisor për projektin i cili duhet të përmbajë masat mbrojtëse dhe rehabilitimin mjedisor.

Paragrafi 2, thotë: pëlqimin për paragrafin 1 e jep ministria.

Neni 31, paragrafi 1: lëshimi në punë i objekteve të ndërtuara apo i stabilimenteve dhe paisjeve që kanë qenë objekt i vlerësimit, ndikimit në mjedis nuk mund të fillojnë veprimtarinë pa marrjen e lejes mjedisore.

Paragrafi 2, leja mjedisore lëshohet për periudhën 5 vjeçare sipas procedurës për pranimin teknik të objekteve dhe stabilimenteve ose pas kryrjes së punës provuese deri në 6 muaj.

Sipas këtij ligji Kryetari nuk ka marrë asnjë vendim që e dëmton qytetarin e K. së Malishevës, por ai ka qenë çdo herë afër qytetarëve dhe i ka përkrahur ata në të drejtat e tyre.

Arlind Morina: Çështja e gurthyesve në fshatin Astrazub është diskutuar edhe në Parlamentin e Kosovës por nuk ka pasur asnjë rezultat e tani po e diskutojmë edhe këtu.

Luan, gjendja në Malishevë është alarmante sepse pluhëri që shkakohet në fshatin Astrazub përhapet me km dhe është kancerogjen. Nga pluhëri i gurthyesëve që mblidhet në rrugë janë shkaktuar shumë aksidente madje edhe me fatalitet.

Uroj që banorëve të Kërvasarisë mos t'ju prijë fati i fshatit Astrazub dhe shpresoj që të merret një vendim për ndalimin e punës së atij operatori dhe të gjithë gurthyesëve tjerë.

Valon Krasniqi: Të nderuar qytetarë duke parë shqetësimin e juaj që lidhet direkt me shëndetin dhe pasojat tjera natyrore dhe materiale. Shqetësimin dhe brengjen tuaj e ndaj me ju duke i shfrytëzuar mundësitë tona si ligjore po ashtu edhe si të zgjedhur nga qytetarët.

Të nderuar asambleistë dhe subjekte politike, nëse për kauzat tona subjektive kërkojmë nga qytetarët që në fushatat zgjedhore pjesëmarrja të jetë sa më masive e pak rëndësi ka a janë të rritur apo nxënës edhe në këto situata kjo nuk duhet t'na duket absurde.

Ne duhet që të mundohemi që të gjejmë zgjedhje për këtë problematikë sepse jeta e qytetarëve duhet të jetë primare për ne.

Hidajete Mazreku: Problematika e gurthyesëve ishte moti që nga Astrazubi. E pashë që shumicë thojnë ja Kryetari është fajtor, ja ministria është fajtorë, ne nuk duhet të fajsojmë njëri-tjetrin por duhet të bëhemi bashkë për ta luftuar këtë fenomen që po na dëmton e që po shtohet dita ditës. Ne e dimë se sa i dëmshëm është ky fenomen për shëndetin, dëmet materiale e ndë duhet me një platëformë të përbashkët ta ndalojmë.

Kryetar çdo mundësi që për të bërë mos ja lë në duar ministrisë por ato masa që mund të merren nga ju dhe nga ne ta bëjmë sot sepse kjo dukuri po dëmton shëndetin e qytetarëve, ambientin dhe ka dëme materiale.

Agon Bytyqi: Ne ju dëgjuam diskutimet e juaja dhe mendojmë që ju duhet të zhveshi nga petku i përditshëm këtu dhe të ndjeni më shumë këtë shqetësim tonin serioz. Ne frigohejmë që kemi institucione kaq të pafuqishme e që nuk guxojmë për të bërë zë në këtë drejtim. Sot ja ka filluar gurthyesi punës e ne po diskutojmë këtu. Nëse ju po pritni që të ndodhë pasoja e mëtej të diskutohet, atëherë është vonë. Prandaj është mirë që të merrni masa tani sepse jeta jonë do të vështirësohet.

Sot e tutje më ne s'kemi punë me institucione ose do të ndalohet puna e këtij gurthyesi ose do ta lëshojmë fshatin.

Avdi Morina: Çështja e gurthyesëve jo vetëm këtë herë por edhe në mandatin e kaluar është diskutuar disa herë por nuk e kemi zgjidhur këtë problem. Problemet zgjidhen duke i trajtuar në baza ligjore. Në kuadër të gjitha diskutimeve që u bënë këtu është mirë që bashkërisht të dalim me një qëndrim të përbashkët. Nuk mund të përdorim standarde të dyfishta për një gurthyes ndryshe për një tjetër ndryshe. Ligji duhet të jetë i njëjtë për të gjithë. Nëse kemi mundësi dhe fuqi për t'i parandaluar atëherë po veprojmë për të gjithë njëjtë si për Kërvasari ashtu edhe për Astrazub.

Propozoj që shefat e grupve të dalin për konsultime 10 min dhe shohim mundësitë ligjore se a kemi këto mundësi që të marrim masa ndaj këtyre operatorëve që po rrezikojnë shëndetin e qytetarëve.

Kryetari- Ragip Begaj: Karshi qytetarëve të Kërvasarisë dhe të gjithë K. së Malishevës jam i bindur se askush nuk është më afër se unë madje ju kam thënë se unë jam me ju edhe në protestë. Nëse dikush është i thirrur për të mbrojtur qytetarin i pari jam unë. Unë kam bisdu me ju dhe jam i gatshëm për të biseduar çdo herë.

Komuna i ka dhënë pëlqim një biznesi privat që është në pronë private për zonën kadastrale Goriq, atëherë e shohim anën ligjore se a kemi pasur të drejtë a jo. Kryetari i fshatit Goriq e ka dhënë pëlqimin që atyre nuk ju pengon.

Prej të gjithë gurthyesëve që veprojnë në K. e Malishevës as një dobi komuna nuk e ka prej tyre përveç që ka dëme. Unë kam bërë kërkesa disa herë për mbështetje për sanimin e dëmëve që po bëhen.

Unë nuk guxoj që t'i anuloj vendimet që kërkuat sepse nuk janë në kompetencat e e mija sepse licencën e ka nga ministria. Unë jam i gatshëm që me ju në të gjitha instancat të kërkojmë mbrojtjen e qytetarëve. Çfarë do vendimi që merrni ne do ta ardesojmë në të gjitha institucionet e larta qendrore që të merren me këtë çështje dhe të shohin të drejtën ligjore.

Arbëreshë Krasniqi: Deklarojë që pëlqimi është dhënë nga drejtoria përkatëse që nuk e pengon Planin Urbanistik të K. së Malishevës dhe nuk e ka ditur drejtori se çka do të ndërtohet aty gurthyes apo diçka tjetër. Këtë e dinë edhe qytetarët e Kërvasarisë.

Nëse të gjithë shefat e grupeve dalim dhe sikutojmë që të gjejmë një zgjidhje të përbashkët kërkesë e imja është që të fillojmë nga Astrazubi e të inicojmë procedura për t'i ndalur këto biznese nga aty. Nëse nuk mund t'i ndalim atëherë le t'i plotësojnë kriteret nëse dojnë të veprojnë si biznese. Shefi i PDK-së që po mungon këtu nuk po mduket shenjë e mirë sepse ne duhet të bëhemi bashkë për këtë çështje e t'i ndalojmë bizneset që nuk i plotësojnë kriteret.

Alban Krasniqi: Secilin asambleist sot këtu e kuptoj nëse ka mungesë të informacionit, paqartësi sepse e kemi të pamundur që t'i dimë të gjitha çështjet. Secili prej nesh kemi dokumente më shumë se sa po na ofron Kryetari. Islam nuk na ke dhënë asnjë dokument e as pëlqimin tënd, kërkesën që ka bërë kompania dhe cilit ligj ju ke referuar për dhënien e atij pëlqimi. Drejtor duhet të dalësh në foltore dhe t'na tregosh me detaje këtë çështje.

Sipas nenit 17, të ligjit për Vetëqeverisje Lokale në kompetencat vetanake që i ka Komuna, pika C, Komuna e ka kompetencë vetanake shfrytëzimin e tokës, mbrojtjen e mjedisit lokal dhe shëndetësinë publike. E jona është të gjejmë zgjidhje dhe të marrim vendim dhe ju Kryetar ju e jetësoni këtë vendim dhe merrni gjithaashtu vendim për shfuqizimin e pëlqimeve edhe pa u bazuar në vendimet tona.

Islam Vrenezi: Përshendetje për të gjithë! kjo kërkesë është e arkivuar me dt. 16.04.2018 duke n'a u drejtuar se ka Plan Urbanistik Komuna në atë parcelë dhe me ato koordinata. Ne jemi konsultuar me PLZHK dhe e kemi parë që s'ka interes Komuna për të ndërtuar diçka. Për të tjerat merret mistria sipas ligjeve dhe kriterëve të veta sepse të tjerat janë kompetencë e tyre.

Dibran Kastrati: Përshendetje! Përveç pëlqimit që është marrur nga Komuna, operatori u është drejtuar Agjensionit të Pyjeve dhe ka marrur një pëlqim tjetër. Pastaj kanë marrur edhe pëlqimin tjetër nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësiror dhe nga Inspektoriati i Minierave dhe Mineraleve e kanë marrë licencën. Ne edhe nëse e heqim pëlqimin që ka lëshuar Drejtoria e Urbanizmit ato të institucionve tjera s'mund t'i heqim.

Sot Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësiror ka qenë në terren dhe e kanë verifikuar që gjithëçka është në rregull dhe licencën e ka deri në vitin 2024.

Rrahim Morina: I lush shefat e grupeve politike që të konsultohemi për 10 min.

Pas konsultimeve me shefat e grupve ku mungoi PDK-ja ne i nxorem disa rekomandime duke u bazuar nga gjendja aktuale e diskutuar këtu. Rekomandimet janë këto:

1. Kërkojmë nga Ministria që të rishqyrtohet e tërë procesi i marrjeve së lejeve e sidomos debatet publike mbi të cilën bazë është dhënë licenca.
2. Kërkojmë nga organet e nivelit qendror Ministria e Ambientit dhe Komisioni për Miniera dhe Minerale që t'i obligojnë gurthyesit që t'i zbatojnë kriteret e punës sipas ligjeve në fuqi
3. Nëse gurthyesit nuk i plotësojnë kriteret e punës mbrenda 3 muajve Kuvendi Komunal do të tërheq pëlqimin në përputhje me kompetencat e tij bazuar në nenin 17, pika c dhe m e ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe bazuar në ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit në Kosovë

Alban Krasniqi: Propozimi imi ishte që të marrim një vendim bazuar në nenin 17 për Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Kuvendi Komunal që të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me dhënien e lejeve për aktivitete që lidhen me gurthyesit pëlqimi të merret këtu në Kuvend. Pastaj pika 2, Kuvendi Komunal të nxjerrë një përshkrim me vendim për procedurat se si do të procedohet marrja e pëlqimit nga ana e Drejtorisë së Urbanizmit.

Rrahim Morina: Propozimin tënd Alban e bëjmë si pikë të veçantë dhe e çojmë në MAPL nëse ajo e konfirmohet që është në rregull pastaj ne e zbatojmë.

Arbëreshë Krasniqi: Gjatë konsultimeve që bëmë për rekomandimet Albani e paraqiti edhe këtë propozim, mirëpo mos jemi në kundërtënie të asaj që po dojnë të bëjnë dhe asaj që mund të bëhen dhe kam disa dilema ndoshta është mirë që ta diskutojmë njëherë. Është mirë që sot t'i votojmë këto rekomandime dhe të presim 3 muaj dhe të shohim rezultatet e pastaj ne përsëri jemi këtu dhe mund të diskutojmë këtë çështje dhe do ta keni mbështetjen tonë.

Rrahim Morina: Shkojmë në votim për rekomandimet e përbashkëta që i nxorem. Rekomandimet i lexova më parë kush është për?

Për: 19, unanimit

Me këtë votim unanim aprovohen këto rekomandime të Kuvendit Komunal drejtuar organeve qendrore.

Atëherë është propozimi i Alban Krasniqit që të marrim një vendim bazuar në nenin 17 për Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Kuvendi Komunal që të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me dhënien e lejeve për aktivitete që lidhen me gurthyesit pëlqimi të merret këtu në Kuvend. Pastaj pika 2, Kuvendi Komunal të nxjerrë një përshkrim me vendim për procedurat se si do të procedohet marrja e pëlqimit nga ana e Drejtorisë së Urbanizmit.

Luan Kryeziu: Kopetenca vetanake, zhvillimi lokal ekonomik në pajtim me Ligjin e Finacave, mbrojtjen e mjedisit lokal. Por, si mbrojtja e mjedisit lokal pa ju qasur ligjit? Për deri sa janë ligjet ne nuk kemi pse të marrim një vendim të tillë dhe ne si grup jemi kundër propozimit të Alban Krasniqit.

Rrahim Morina: Propozimi i Albanit është kështu: nga sot e tuje që të marrim një vendim bazuar në nenin 17 për Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Kuvendi Komunal që të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me dhënien e lejeve për aktivitete që lidhen me gurthyesit pëlqimi të merret këtu në Kuvend. Pastaj pika 2, Kuvendi Komunal të nxjerrë një përshkrim me vendim për procedurat se si do të procedohet marrja e pëlqimit nga ana e Drejtorisë së Urbanizmit. Kush është për?

Për: 8

Kundër: 9

Abstenim: 2

Me këtë votim nuk kalon propozimi i Alban Krasniqit.

Atëherë me kaq për sot po e përfundojmë pjesën e I-rë të mbledhjes, vazhdimi mbahet të Premten në ora 10.

Mbledhja përfundoi në ora 17:20.

*

*

*

Vazhdimi i mbledhjes së XII-të të rregulltë të Kuvendit të Komunës së Malishevës e cila mbahet me dt: 07.12.2018.

Mbledhja filloi në ora 10:40. Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin 19 asambleistë, Kryetari, drejtorë komunalë, përfaqësuesi i OSBE-së dhe media.

Rrahim Morina: Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Është mirë që t'a respektoni orarin sepse po fillojmë 40 min me vonesë dhe kjo është e pa justifikueshme. Po vazhdojmë me vazhdimin e mbledhjes së XII-të të rregulltë dhe kemi shqyrtuar vetëm dy pika të rendit të ditës. Sipas radhës kalojmë në pikën e 3-të të rendit të ditës: Informimi nga Drejtoria për Bujqësi rreth mbjelljeve vjeshtore dhe ndarjes së subvencioneve. Udhërmoni drejtor!

Murat Hoxha: Përshendetje për të gjithë! Plani Operativ për Mbjetlljet Vjeshtore është duke ndodhur me vonesë dhe janë në procedurë të mbjelljes për arsye të motit. Në këtë vit janë mbjellur kulturat bujqësore si gruri, elbi, thekra dhe tërshëra. Në sektorin privat janë palnifikuar të mbjellën 3.662 hektarë.

Për të arritur rendimentet të arsyeshme janë të domosdoshme që të kryhen të gjitha operacionet punuese në kohë dhe afat optimal. Në mënyrë tabelare i keni të gjitha të dhënat.

Rrahim Morina: E hapi debatin për këtë pikë.

Alban Krasniqi: Sot po e diktujmë Planin Operativ të mbjelljeve vjeshtore ndonëse kemi hyrë në dimër e dimë që edhe moti ka qenë i thatë dhe jo i përshtatshëm për mbjellje.

Raporti është i varfër në përshkrim sepse nuk është i mangët planifikimi, sfidat etj. Neve na duhen nga drejtori të dhënë më kullitativave dhe sasiore në të njëjtën kohë.

Plani operativ i dedikohet edhe asaj se çka ke për të bërë edhe asaj se si ke ardhur deri aty, duhet të ketë një rezultat dhe duhet t'i parasheh edhe rreziqet dhe nuk ka parametra paraprak dhe nuk ka bazë se si është bërë planifikim. Statistikat që keni dhënë drejtor janë të pamjaftueshme. Sa është fondi i përgjithshëm i tokës bujqësore në sektorin privat që ta dimë se sa është duke u punuar? Cila ka qenë ndihma konkrete e komunës në raport me këtë planifikim në kuptimin e suvencionimit të bujqëve me farë, pleh dhe derivate të naftës. Nëse ka pasur, sa ka pasur dhe si janë shpërndarë? Nëse s'ka pasur, pse nuk ka pasë?

Sylë Dukolli: Përshëndetje për të gjithë! Ky plan është përgatitur në mujin e 10-të pra para dy muajsh dhe ishte më shumë informues se cilat kultura bujqësore do të mbillen, por e dimë të gjithë që klima ka qenë e pa përshtatshme sidomos për mbjelljen e grurit.

Ne kemi vetëm sektorin privat që kultivon këto kultura bujqësore dhe kërkoj që në të ardhmen të ndihmohen me fara, pleh dhe derivate.

Ne jemi vend bujqësore por neve si Malishevë na mungon uji për ujitje që rendimentet të jenë më të mira. Ky raport është si "kufini mbas të vjelurave" sepse jemi në fazën e përmbylljes të të mbjellurave.

Halil Morina: Përshëndetje për të gjithë! Pajtohem me Albanin që materiali është pak i mangët, por jam i bindur që drejtori nuk ka dashur që t'na ngarkoj shumë. Ne jemi në një rajon bujqësor dhe duhet të bëjmë përpjekje të mëdha që t'i stimulojmë bujqit që të mbjellin kultura bujqësore që të ardhem të sigurojmë bukën vet. Për mbështetje dhe stimulim ka nevojë edhe sektori i blegtorisë.

Nëse rikthehemi te buxheti që ne e kemi bërë Alban, i kemi tërhek 200,000.00€ prej sektorit të bujqësisë dhe i kemi destinuar për parqe nëpër fshatra. Ky është një problem i madh. Unë kërkoj që të rishikohen këto gjëra dhe të destinohen më shumë mjete për stimulimin e bujqësisë.

Nebih Bibaj: Përshëndetje për të gjithë! Halil, sa i përket shumës së tërhequr nga bujqësia duhet të pajtohem të gjithë që bujqësia nuk shkon me motokultivatorë dhe me nga 1 ari serë.

Në këtë raport nuk po dihet saktë se sa kemi tokë pjellore dhe sa jën mbjellur. Drejtor dua sqarim për këtë. Nëse përqindja është e ulët është mirë pastaj me dal në terren e me sensibilizuar opinionin për mbjelljen e tokës. Drejtor a ka ndonjë prag për derivatet e naftës ose në çfarë mënyre jepen?

Alban Krasniqi: Më kujtohet kur kemi punuar me kolegët e tjerë në buxhet është që në fakt bujqët do të përfitojnë më shumë. Ne në atë planifikim kemi ndarë buxhet për pleh, derivate dhe farë, që këtë nuk e keni bërë. Janë diku 70-80,000.00€ që janë ndarë për ndërmarrje prodhuese në

sektorin e bujqësisë është diçka që nuk ka ekzistuar më parë. Kjo është për një bujqësi më të planifikuar dhe profitabile.

Halil Morina: Nebih dhe Alban në rregull do të ishte sikur ato mjete sikur ato mjete t'i kishit destinuar në një lloj tjetër investimesh në bujqësi e jo t'i tërhiqni nga aty. Ju e keni zvogëluar buxhetin e bujqësisë për 200,000.00€ dhe ja çuar në parqe. Ne nuk kemi nevojë në fshat që të bëjmë park sepse aty ka mjaft gjelbërim.

Rrahim Morina: Për mua shqetësuese është sepse 50% e tokës është ndjerrinë nëpër fshatra. Cili është aktiviteti dhe mundësitë qoftë e Kuvendit apo e Qeverisë që të ndritet një veprimtari e tillë? Mendoj të organizohen tryeza me me ekspertë të kësaj natyre. Njëra nga stimulimet është që t'ju ndihmojnë me derivate, marrja e kredive me përqindje të stimuluar nga komuna, të gjenden mënyra për ujitjen e tokës bujqësore. Nuk zhvillohet bujqësia me motokultivatorë, makina mjelëse. Bujqësia zhvillohet me ngritjen e fermave, serave dhe gjëra të tilla. Askund nuk shkruan në raport se cilat janë kriteret për ndarjen e subvencioneve sepse stimulohet njeriu i subjektit politik. Në Banjë më duket është një Qamil që ka një shtallë jo të mirë e ka afër 30 lopë e ai nuk është ndihmuar. Le të përfitoj ai mbi bazën e kriterëve.

Arbëreshë Krasniqi: Përshendetje për të gjithë! Drejtor e rëndësishme është që sektori i bujqësisë po ndihmohet dhe po zhvillohet dita e ditës. Është e vërtetë që nëse një lopë i jepet një fermeri është stimulim, edhe motokultivator i e makina mjelëse. Halili mirë e pati kur e trajtoj çështjen e stimulimit dhe ndarjes së buxhetit për zhvillimin e bujqësisë.

Alban Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Halili e tha që më ndërhyrjen e opozitës është zvogëluar edhe buxheti për bujqësi. KPF-ja ju është drejtuar me disa kërkesa Drejtorisë për Bujqësi që ajo t'ja jep një Plan të Punës për vitin 2018, por kjo drejtori nuk ju është përgjigjur KPF-së. E njëjta kërkesë ju ka drejtuar edhe Kryetarit të Komunës por përsi ajo nuk ka marrur përgjigjie.

Drejtor, tek ndarja e subvencioneve për motokultivatorë, ndarjen e lopëve, ndërimin e fermave tek përfituesit hasa që i njëti përfitues ku marrë edhe motokultivator edhe lopë dhe i njëti ka marrur fermën e që është militantë i paritës së juaj. Ju nuk po e mbështetni Hashim Paqarizin nga Pallanka e që ka bërë kërkesa dhe ka plotësuar kriteret.

Arbëresha në mbledhjen e kaluar në pikën kur bisedohet për gurthyesit në K. e Malishevës thotë që shefi i grupit të PDK-së e lëshon mbledhjen. Para se ta lëshoj mbledhjen ka qenë i njoftuar Kryetari për arsyen se pse. Arsyeja ishte sepse djali im e ka thyer këmbën në fushën e sportit për shkak të mos rrafshimit të asaj pjese dhe është në gjendje të tmerrshme e që nesër e keni prorurimin. Grupi i asambleistëve të PDK-së e mbështetë çdo kërkesë të qytetarëve të K. së Malishevës por jo të politizohen gjërat, dhe të respektohen të gjitha kriteret që i ka përcaktuar KPM-ja dhe ligjet në fuqi. Nëse këta gurthyes nuk i plotësojnë këto kriterë ne kemi të drejtë që t'ja heqim pëlqimin e lëshuar nga Komuna.

Hashim Vrenezi: Pershendetje për të gjithë! Po më vjen mirë që disa nga asambleistët e NISMA po e pranojnë që buxhetin e ka hartuar opozita dhe është e vërtetë! Halil është mirë të ketë ide për parqe, për bujqësi dhe në secilën fushë që e prek qytetarin.

Ne nuk jemi fajtorë që drejtori i Bujqësisë nuk e ka asnjë politikë zhvillimore të bujqësisë që na është prezantuar neve për ta parë se nga të orientohet zhvillimi i bujqësisë. Ne nuk jemi për të

ndarë shuma e për t'i çauar tek votuesit e NISMA në mënyrën më të keqe të mundshme ku në fshatin tim përfituesit e këtyre motokultivatorëve ende pa u shpërndarë është ditur se kush do t'i merr. Kjo është shqetësuese për neve.

Efikasitet më të madh do të jep shuma që e kemi ndarë nëpër sfera të caktuara të bujqësisë se sa NISMA që ka ndarë subvencione për bujqësinë e që kanë pasur efekt 0 dhe janë ndarë për çështje elektorale.

Luan Kryeziu: E falemnderoj drejtorin për punën që ka bërë sa i përketë këtij Plani. Sa i përketë ndarjes së subvencioneve ajo ka qenë publike në ëeb-faqen e komunës me listat e përfituesve. Ky drejtor po bënë një punë të mirë që është për t'u përshëndetur.

Sa i përketë buxhetit ai është i Kryetarit po ka të bëjë me çështjen e propozimve ajo që tha Halili. Ato propozime kanë tentuar që ta dëmtojnë këtë sektor. Ne si Kuvend duhet që t'i japim çdo herë hapësirë bujqësisë me investime sepse tani ka hapësirë prodhimi vendor me taksën 100%.

Alban Mazreku: Luan, fola për gurthyesit që të arsyetoj mungesën time atë ditë në Asamble.

Nebih Bibaj: Luan, është mirë që kur të përmendet taksa 100% kundër prodhimeve serbe të përmendet Qeveria e Kosovës që përbëhet nga 3 parti politike e jo të fokusohesh veç tek subjekti yt.

Demir Bajraj: Pershendetje për të gjithë! I përcolla diskutimet e parafolesve të mi dhe habitem nga fakti se si thojnë disa se ndarja e subvencionve është bërë në baza partiake. Flas për fshatin tim Panorc dhe sipas listës së përfituesëve për maknina mjelëse janë: Halil Bajrami, Sami Sadiku, Burim Sahiti dhe ju PDK-ja e dini se i cilës parit është ky. Përfituesit e kosherve të bletës janë: Haki Ramadanaj, Sadri Bajramaj, Skender Sahiti, Ganimete Bajra, e dini ju se sa individë i takojnë NISMA. Përfituesit e motokultivatorëve janë: Besim Demaj, Rrahim Bjarami, Rustem Sadiku, Halil Sejdiu dhe e dini se cilës parti i takojnë këta njerëz. Panorci duhet të jetë model për të gjithë ju këtu.

Luan Kryeziu: Ne sot nuk është dashur që ta thrrasim drejtorin e Bujqësisë sikur te mos ishte ky vendimmarrës. Në kuadër të Ministrisë së Industrisë dhe Tregtisë sikur të mos ishte edhe ajo vendimmarrëse nuk është dashur fare të ekzistoj po të vendosë dikush tjetër mbenda Qeverisë, kjo është Nebih.

Alban Krasniqi: Ne dolem prej temës por mbrenda sektorit sepse na është mohuar kërkesa jonë që të diskutojmë për mënyrën e ndarjes së subvencioneve. Unë i kam bërë dy kërkesa vjet dhe nuk kam marr ende përgjigje dhe kam ngritur padi për drejtorin në emër të interesit të qytetarëve. Unë nuk i kam kërkuar vetëm listat por edhe kriteret se si ndahen.

Rustem Hoti është Kryetar i Fshatit Carrallukë dhe ka marrë shtallë me kriterin e vetëm që ishte anëtar i NISMA. Rasti tjetër Adem Krasniqi vëlla i dëshmorit, bashkëluftëtar i imi, Hasan Zogaj nga Lladroci luftëtarë i devotshëm i UÇK-së kanë bërë kërkesë për motokultivatorë dhe kanë tokë me hektarë dhe asnjëri s'kanë marrë. A thua pse?! Sepse ata jo vetëm që s'janë në NISMA, por janë edhe kundërshtarë të padrejtësive. Kjo po shihet se si ndahen këto subvencione. Është mirë që të reflektoni Qeverisja Lokale e të bazoheni në kriteret.

Te buxheti për bujqësi që është ndarë në këto linja 350,000.00€ afërsisht: finacimi i fermerëve me fara dhe plehëra që nuk hynë në kategorinë e subevcionimit nga qeveria, finacimimi i

fermervet në ngritjen e serave, financimi i fermerëve në ngritjen e pemishteve, financimi i fermereve në kosulidimin e ngritjeve të fermave blektoriale, suvencionimi i ndërmarrjeve prodhuese bujqësore, financimi i fermereve me mekanizëm bujqësorë paisje, financimi i fermerëve me traktorë. Kaq kemi mundur të bëjmë dhe këtë e kemi bërë.

Për vitin e ardhshëm bashkarisht do ta bëjmë një Rregullore për Subvencionet e që cakton kriteret e sakta që të gjithë të flegjë më rehat.

Ali Morina: Pershendetje për të gjithë! Kam një pyetje lidhur me Planin Operativ. Drejtor, a është planifikuar edhe 3,236 hektarët për mbjellje? Ne e dimë që kushtet klimatike janë të pafavorshme dhe nuk do të realizohen këto të mbjellura. Krahasuar nga vitete e kaluara sa i plotësojnë nevojat e qytetarëve të mbjellurat me grurë dhe cilat janë masat stimuluese që i keni ndërmarrë që kjo kulturë bujqësore të mbjellet më shumë?

I nderuar Luan, është fakt që ekziston lista e përfituesëve në veb-faqen e komunës por jo edhe të aplikuesëve dhe cilat janë kriteret se si zgjidhet një X-person.

Demir Bajraj: Kjo vlenë për të gjithë edhe për ju Ali. A mendoni sikur ju ta kishit pozitën sot, populli i Malishevës a do të ishte e kënaqur me ndarjen e subvencioneve? Telashe me pronat kanë shumë qytetarë dhe është e vështirë të ketë ndarje korrekte.

Valon Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Epiqendra e problemit për këtë çështje është se drejtori merr informacione dhe rekomandime nga kryetarët e nëndegëve të subjektit të tij dhe jo nga kryetarët e fshatrave dhe shpeshherë është i keqinformuar ndoshta duke ju besuar më shumë se sa duhet ashtu siç e përmendi rastin për fshatin tim Albani më heret. Fazliu i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe ja kam rekomanduar edhe drejtorit këtë. Shqetësuese tjetër për këtë çështje është se përfituesit janë të ditur para se të ndahen këto subvencione.

Sadije Krasniqi: Drejtor kam 2 pyetje për ju. Përmes rritjes së përkrahjes së vazhdueshme nga viti në vit si nga Drejtoria e Bujqësisë në Malishevë ashtu edhe nga Ministria e Bujqësisë, a është rritur numri i fermerëve dhe a janë rritur këto sipërfaqe? A ka në plan Drejtoria e Bujqësisë të përkrahë bujqësinë organike?

Hidajete Mazreku: Pershendetje për të gjithë! Drejtor kam një pyetje lidhur me serat. Serat janë dhënë që të zhvillohet bujqësia dhe që të rritet prodhimi. Drejtor sa kanë prodhuar këto sera, a janë duke u mirëmbajtur ato sera dhe si është puna e tyre?

Ne si asambleistë është mirë të formohet një komision që t'i vizitojë këto sera dhe në të ardhmen nëse është nevoja të rriten me sipërfaqe këto sera në qoftë se kanë prodhime vendore që i plasojnë në treg.

Unë me Komisionin për Barazi Gjimore kemi vizituar një përfituese femër të serës 25 ari nga Ministria e Bujqësisë dhe një serë tjetër prej 3 ari dhe familja Maloku ka prodhuar specat, domate që kanë qenë profitabile. Kjo familje ka pasur nevojë për një pus për ujitjen e serave, dhe kanë bërë kërkesë deri ku ka shkuar kjo çështje?

Rrahim Morina: Drejtor, ju e keni fjalën për përgjigje dhe sqarime.

Murat Hoxha: Ndihamat konkrete nga Komuna e Malishevës ku janë shpërndarë 80 copë shpërndase të plehut, tani është nënshkruar kontrata për 40 makina mbjellse të grurit në vlerë afërsisht 3,000.00€ e që do të shpërndahen shumë shpejt dhe 40 spërkatëse të grurit.

Ne gjatë gjithë kohës kemi mbajtur takime me fermerët që merren me kulturat bujqësore, vreshtarë dhe ata që kultivojnë bimë medicinale. Ne kemi parë nga afër kërkesat e tyre dhe pastaj e bëjmë planifikimin.

Kryesuesi e përmendi Qamil Begaj që nuk ka përfituar shtallë. Është e vërtetë që ai i ka kushtet shumë të vështira me shtallë por ai asnjëherë nuk ka aplikuar. Në njoftimin e fundit për ndarjen e shtallave i kam shruar edhe sms në tel. dhe e kam njoftuar që duhet të aplikojë. Ja shihe Kryesues.

Alban, fermeri Hashim Paqarizi ka përfituar makinë mjelëse dhe ajo makinë është shitur në Senik.

Ali, mbjellja e grurit nuk i plotëson nevojat e K. së Malishevës sepse çdo vit po bie numri i mbjelljeve të grurit dhe të kulturave tjera bujqësore.

Sadije, së fundmi jemi duke i përkrahur edhe ata që merren me bimët mjeksore siç është Shefqeti nga Tërpeza e që është ndihmuar gjatë gjithë kohës nga komuna.

Profesorësha Hidajete, ato sera jën duke u mirëmbajtur dhe me aq buxhet sa kemi ne është pakë që të japim sera edhe më shumë. Kam vizituar edhe vet familjen Maloku dhe është shapllur 3 herë tenderi për hapjen e atij pusi por nuk ka konkuruar askush. Tani përfituese është një kompani nga Prishtina dhe shpresoj që këto ditë do të filloj hapja e atij pusi.

Rrahim Morina: Falemnderit drejtor! Shkojmë në pushimin e drekës dhe kthehemi në ora 13:15.

Pas pauzës jemi kthyer dhe mund të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e 4-ërt të rendit të ditës: Informimi nga Kryetari i Komunës për mbështetjet e familjeve të varfra. Urdhëro Kryetar e keni fjalën!

Kryetari-Ragip Begaj: Pershendetje për të gjithë! Singerisht po me mundon joseriozoiteti që nuk po vini me kohë. Kjo është një vërejtje serioze sepse duhet ta dini pse jeni të thirrur këtu!

Ndihma jonë më e domosdoshme ka qenë strehimi i disa familjeve që kanë pasur shumë nevojë. Ju e keni materialin dhe në planin tonë janë ndërtuar 8 shtëpi 2 nga këto janë me “Jetimat e Ballkanit” një në Malishevë dhe një në Lladroc. Në Banjë është ndërtuar një shtëpi në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe shoqiata ashtu edhe në Ngucat që është ndërtuar në bashkëpunim me shoqatat e dalura nga lufta e gjithësej për këtë vit bëjnë 10 shtëpi që janë ndërtuar. Dje janë lëshuar për banim edhe 2 shtëpi tjera që janë ndërtuar nga kompania “Hazrolli” që publikisht i falemnderoj shumë!

Në këtë vit kemi ndërtuar 5 pullaze, 4 merimetime që të gjitha janë të shënuara me vlera që i keni në material diku 110,962.46€ në total për të gjitha.

Ky kontribut është i përbashkët dhe shpresoj që Malisheva së shpejti të bëjë zgjidhjen e banimit edhe me ndërtesën kolektive që do të ndërtohet së shpejti.

Ne kemi ndarë edhe ndihma individuale ku hynë edhe bursat për studentë, rastet për smundje të ndryshme, shërimin jashtë vendi etj. Të gjitha i keni në material madje edhe përkrahjen me barna e nuk po lëshohem në emra individual. Nëse keni ndonjë pyetje unë jam këtu do t’ju përgjigjem.

Rrahim Morina: Drejtor, sqaroje se prej ciles kategori buxhetore janë marrë këto mjete që përmendi Kryetari? Pastaj e hapi debatin.

Valon Mazreku: Përshendetje për të gjithë! Këto shpenzime janë të buxhetuar në kuadër të shpenzimeve kapitale, mirëpo që nuk janë asete të Komunës për vet faktin se mënyrat tjera të buxhetimit nuk ka pasur mundësi që të realizohen.

Nebih Bibaj: Respekt për ndihmesën që keni bërë për familjet që kanë pasur nevojë. Muhare, dhe Kryetar deri në çfarë shume keni pasur të drejtë të ndani mjete? A ka të drejtë Kryetari që të heq mjete nga investimet kapitale pa vendim të Kuvendit?

Alban Krasniqi: Përtej diemsonit të ndihmesës, ndërtimit të shtëpive etj. është edhe diemsoni tjetër ligjor që kuhet të korrespondoj. Nëse dikush mundohet të mbulojë mungesën e procedurave në emër të dimensionit human e konsideroj keqpërdorim të foltotres dhe detyrës. Unë jam i interesuar që ta gjejmë zgjidhjen tani e tutje për raste të tilla për t'ju siguruar kulmin atyre që kanë nevojë të sigurohemi që të jenë me procedura të rregulltua sepse janë raste të ndjeshme.

Kritikoj Kryetarin që në të ardhmen t'i shmanget videove live kur bëhet propozimi i atyre shtëpive sepse po shihet që po ndjehen keq ato familje dhe mos e merr atë grupin tënd me vete sepse është një perrurimi i ulët i vetëvetës.

Kryetar, çka keni vërejtë në ato shtëpi që keni ndërtuar? A ka pas ndonjë shtëpi që nga fund deri në kry që keni ndërtuar? Këto janë projekte komunale dhe nuk guxon që t'u shihen tjegullat shtëpive, kabllot e rrymës jashtë. Pra është një numër i madh i veprimeve paraprake deri te promovimi i juaj aty. Ky është dimensionin hamani që duhet patjetër të përmbushet.

Dua ta di që proceduaralisht si vie deri te vendimi se kujt duhet t'i ndërtohet një shtëpi e kujt jo? Cili është ai organ që e merr këtë vendim? A duhet të jetë Kuvendi Komunal? A duhet të autorizojmë Kryetarin në që mos të ketë shkelje? Për këto nuk ka vendos Kuvendi edhe pse di që ka pasur kërkesa që na janë drejtuar. Si të sigurohem që po bahet kjo ndarje në mënyrë adekuate? Si të sigurohem unë që kompania që ka fituar tenderin për ndërtimin e këtyre shtëpive që i ka plotësuar ato kritere që janë kërkuar? Si janë bërë palnifikimet për ndërtimin e këtyre shtëpive? Kush ka marrur vendim për ndërtimin e këtyre shtëpive, cili komision? Të gjitha këto janë çështje që ne duhet t'i diskutojmë sot. Në këtë mënyrë si sot është duke u punuar ilegalisht. Ne duhet të gjejmë një zgjidhje që ta legalizojmë me procedura të rregullta.

Shkelje ka pasur edhe në ndarjen e bursave sepse Nënkryetari me atë komisionin e vet i kanë vu kriteret e në fund u janë shpërndarë bursa të gjithëve që kanë aplikuar. Nuk është aspak mirë sepse studenti që nuk e ka gjetur vetën në kriter nuk ka aplikuar fare e pra i është mohuar mundësia për të fituar bursë.

Astrit Sertolli: Përshendetje për të gjithë! E falemnderoj Kryetarin për gjithë këtë punë që ka bërë për familjet më nevojë dhe se komisioni ka vlerësuar saktë këto familje!

Sylë Dukolli: Ne si popull jemi humanist edhe Kryetarin e kemi shumë humanitar. Ne krahasuar me komuna tjera jemi komuna më e varfër dhe më së shumti ju kemi dal në përkrahje qytetarëve tanë. Puna e Kryetarit nuk ka qenë reklamë por një kulm për një familje që të jetojnë në mënyrë të dinjitetshme.

Sa i përket procedurave së zgjedhjes së familjeve se kujt duhet t'i ndërtohet një shtëpi. Qytetarët kërkojnë në Qendren për Punë Sociale dhe sipas gjendjes dikush aty për aty strehohet duke e sistemuar me qera e dikujt i ndërtohet shtëpi, varësisht prej gjendjes në të cilën është.

Nëse duam të punojmë me standarte dhe të bëjmë një plan ndërtimi për një shtëpi për të bërë një projekt ne duhet që t'i harxhojmë 100,000.00€ për një shtëpi në total. Prandaj ne jemi që numri i të strehuarve të jetë më i madhe e të ndërtohen më shumë shtëpi.

Kryetar, më vjen mirë që të gjithë kanë përfutur bursa sepse ne duhet sa më shumë të investojmë në rini dhe do ta kemi një shoqëri të civilizuar dhe të dinjitetshme.

Halil Morina: Po ndjehem mirë që sot 8 familje nuk kanë për ta ndërterë të ftohtin e këtij dimri! Dua ta falemnderoj familjen Hazrrolli, shoqiaten "Jetmiat e Ballkanit" e Kryetarin e komunës që takasat e qytetarëve i ka orientuar aty ku duhet! Unë dhe secili taksapagues i K. së Malishevës do të ishte i kënaqur që këto mjete shkojnë në vendin e duhur dhe në bazë të prioriteteve.

Pajtohem me parafolësit për kriteret dhe procedurat që të respektohen e që janë të vogëla krahasuar me aspektin huaman. Hajdeni ne si Kuvend po i ndajmë edhe 200,000.00€ për këtë kategori. mbase po doni që Kuvendi me vendos dhe shkoni ju të gjithë aty në promovim të shtëpvie.

Valon Krasniqi: Përveç që falemnderoj Kryetarin i falemnderoj edhe shumë mërgimtarë ndër ta edhe Bashkim Shala nga Ngucati për humazmin e treguar!

Kam një sygjërim për Kryetaritn se një familje në Kërvasari ka nevojë për ndërtimin e shtëpisë dhe në qoftëse ka ndonjë mundësi sa më shpejt të bëhet diçka për atë familje.

Arbëreshë Krasniqi: Pajtohem me shumë gjëra që debatuan parafolësit por Kryetari nuk po bënë politikë duke bërë fotografi siç tha Hashimi. A po bëjmë politke ne këtu që po shesim moral për ato familje që kanë pasur të ftohtë për vite të tëra e që s'kanë pasur kulm mbi kokë e në po bëjmë demagogji për njerëzit që me të vërtetë ju kanë gëzuar cilit do investim.

Në emër të grupit dhe timin e falemnderoj Kryetarin Begaj dhe të gjithë atyre që ju kanë ndihmuar familjeve që kanë pasur nevojë! Kjo praktikë duhet të jetë model për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe komunat tjera prandaj është mirë po publikohen nëpër rrjete sociale.

Sa i përket këtyre emrave nuk guxoj të paragjykoj që komisioni ka bërë mirë apo keq sepse në mesin e familjeve të varfëra secili ka nevojë dhe është zgjedh ai i cili ka qenë ma më nevojë. Këtu secili prej neshë është dashur vetëm të të falemnderojmë për punën që po bënë dhe të urojmë e ta përkrahim që për vitin tjetër të strehojmë sa më shumë familje. Ne të gjithë unanimisht këtu kemi vendosur për banimin social edhe ky është një shërmim i yni për këtë çështje prandaj ne të gjithë se bashkë jemi që t'ju ndihmojmë atyre familjeve që kanë nevojë.

Filloreta Bytyqi: Ndoshat është lehtë që të falsim ne këtu sepse nuk jemi nën lëkurën e tyre, por ne të paktën po bashkëndjemë me aty. Kryetar të përgëzojë për punën tuaj që sot 8 familje kanë gjetur strehim! Edhe unë kam pasur qef të kem një shtëpi më ta madhe e ma të mirë, por nuk i kam mundësitë, pra mbrenda mundësive të paktën ju kemi lehtësuar mënyrën e jetesës. Kryetar të falemnderoj publikisht për Xhevat Bytyqin sepse nuk ka pasur më nevojtar se ai për shtëpi si dhe për Bukuriye Bytyqin për renovimin e pullazit të shtëpisë! Në të ardhem uroj që të zvogëlohet numri i këtyre familjeve që kanë nevojë për shtëpi!

E potencoj Valoni, e kemi diskutuar edhe me Kryetarin për një familje tjetër që ka nevojë për një shtëpi dhe bashkarisht besoj që do t'ja dalim e t'ju ndihmojmë të gjithë atyre që kanë nevojë.

Alban Mazreku: Kryetari e ka bërë një punë të mirë, por është bërë me paret e taksapaguesëve të Malishevës. Një prafolëse e imaja tha që është mirë që secili prej neve nga një nxemje me u çu këtyre familjeve, por KEDSI menjëherë do t'ju këpuste rrymën sepse ata s'kanë për ta paguar. Ka kërkesa të shumëta për ndihmë nga familjet, prandaj është mirë që të jenë edhe kriteret për seleksionimin e familjeve që kanë më shumë nevojë.

Halili kërkoi që të rrihet buxheti për këtë kategori edhe ne pajtohemi me këtë por të rritet me disa kriteret. Kërkoj në emër të PDK-së një koncesius nga subjektet politike këtu që të merret një vendim ku parashihet krijimi i një komisioni që cakton kriteret për përfituesit e këtyre shtëpive dhe i kishim ndihmu Kryetarit me këtë, nuk e kishim leju që të shkillet ligji dhe Kuvendi e ka këtë të drejtë mbase e miraton edhe buxhetin dhe mund ta ndryshonim shumën me rishikimin e buxhetit për këtë çështje. Publikisht i kam thënë Kryetarit që më shumë e mbrojmë ne si opozitë se sa asambleistët e NISMA.

Rrahim Morina: Në bazë të diskutimeve po krijohet përshtypja ndonjëherë sikur Kryetari i ka dhënë këto para nga xhepi i vet e donatorët po mbesin nën hije. E gjithë kjo punë është meritë e përbashkët dhe qytetarëve të K. së Malishevës sepse janë paratë e tyre e Kryetari i menaxhon ato. Nuk është model veç K. e Malishevës por ajo e Prizrenit ka ndërto 28 shtëpi, e Istogut çdo vjet nga 8-të, por sa më shumë që të ndihmohen familje është mirë.

Përfituesit individual në këtë listë nuk janë përfshirë të gjithë sepse KPF-ja ka ndihmuar 3 persona e 2 nga aty i kanë marrur dhe 1 jo e ata emra nuk figurojnë në këtë listë.

Sa i përket bursave ne kemi nxjerrë një Rregullore për Ndarjen e Bursave që kurrë nuk është respektuar dhe as kriteret që ajo vendos.

Ekziston edhe Rregullorja për Subvencione dhe Trasfere dhe Kryetari ka të drejtë që për ndihmë individuale t'i ndaj deri 500€, për kompani deri në 1,000€ pjesën tjetër për ndryje Kuvendi Komunal ja ka dhënë të drejtën KPF-së.

Propozoj që të formohet një komisioni që të vendos kriteret dhe të zgjedh familjet që përmbushin kriteret për banimin social e njëjtë edhe për familjet do t'i ndihmojë Komuna e Malishevës.

Hidajete Mazreku: Më vjen mirë që janë ndihmuar këto familje dhe të gjithë jemi që të ndihmohen ato familje që kanë nevojë. Për çdo ndihmë që jepet nga K. e Malishevës duhet të respektohen ligjet dhe të specifikohet se prej cilit zë buxhetor janë dhënë ato mjete.

Te subvencionet individuale janë të përfshira edhe bursat, ndihmesa për smundje, rastet me kancer por nuk është specifikimi se si janë aprovuar këto kërkesa. Këtu është përfshire vetëm Xhilda Voci-Thaqi me kancer e që ka bërë zhurmë sepse ju kanë ndarë 200€ e që janë pak e që ka kërkuar që të formohet një fond për këtë kategori. Ne e dimë se sa raste kemi me kancer. Detajizme duhet të ketë edhe për ndarjen e bursave për studentë dhe jam që të ndihmohen sa më shumë e sidomos studentat e mirë e që e kanë notën mesatare 9.

Ne me Komisionin për Barazi Gjonere kemi përgatitur disa fletusha për dhunën ndaj grave dhe ne kemi kërkuar që ajo fletushë të subvencionohet nga K. e Malishevës që të shtypet dhe të organizohet një takim me gra. Ndërsa Nënkryetri thoshte që nuk ka dhunë në Malishevë ndaj grave, ndërsa unë dal me rekomandime ndaj kësaj dhunë.

Ilaz Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Invalidi i luftës Zenel Thaqi nga fshati Mirushë bënë disa herë kërkesë për ndërtimin e një shtëpie dhe nuk e di a ja keni shqyrtuar kërkesat dhe a e keni vizituar ndonjëherë për gjendjen të cilën e ka.

Luan Kryeziu: E falemnderojmë Kryetarin për mbështetjen e familjeve të varfëra dhe të shtresave tjera dhe kjo e argumenton që është mandati i dytë për të dhe kjo është përgjigjia më e mirë që Kryetari është afër qytetarëve të vet. Reklamat bëhen më shpesh për të argumentuar mbështetjen e donatorëve të ndryshëm.

Duke ju referuar pikës së rendit të ditës: Informim nga Kryetari i Komunës për mbështetje e familjeve të varfëra dhe në bazë të kësaj ne nuk duhet të marrim ndonjë vendim sepse është veç informim.

Alban Krasniqi: Përpara e kam një dokument që e kemi pasur aprovuar këtu për planin e banimit social. As Kryetari e askush tjetër nuk e përmendi që ai plan ekziston dhe asnjë debat nuk u bazua në atë plan. Ne e kemi një plan 3-vjeçar për banim social dhe mbrenda tij janë edhe këto raste. Pra sot edhe këto ndërtime kur po bëhen nuk po respektohet ky plan që vet Asambleja e ka aprovuar. Nëse një shkollë ndërtohet me të gjitha standardet edhe shtëpia e një të varfëri duhet të ndërtohet me të gjitha standardet.

Kërkoj nga qeverisja që këtë Planin për Banim Social që t'ju shpërndaj asambleistëve të kësaj legjislature dhe ta mbanjë një pikë të veçantë të rendit të ditës për banimin social. Nuk duhet të ndjekim procedura të ndryshme për ndërtimin e banimit social dhe për ndërtimine e këtyre shtëpive. Dallimi i vetëm është prona ajo publike dhe private.

Propozoj që ne të marrim sot një vendim që të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me ndërtimin dhe renovimin e shtëpive të rasteve në nevojë që kapin shumën mbi 1000€ Kuvendi Komunal të merr vendim. Vendimi të merret për secilin rast veç e veç sipas ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi dhe shtëpitë të ndërtohen sipas standardeve.

Demir Bajra: Si shumë po i stërzgjatim pikat e rendit të ditës me debat. Puna dhe sigureteti të bëjnë që të flasësh mirë për Kryetarin prandaj po e lavdojmë Alban. Ju po mundoheni që të gjitha kompetencat t'ja merrni Kryetarit Begaj e që ai ka ardhur këtu me votën dhe besimin e qytetarëve. Kryetari i ka kompetencat e veta, pavarësisht që ju po thirrreni në do ligje. 15% të buxhetit Kryetari e ka të drejtën e vetos që t'i dedikon aty ku ai mendon që është më mirë.

Ne duhet t'i gëzohemi faktit për mundësin e strehimit të atyre familjeve, ndarjes së bursave e suvencioneve tjera. Mos të bastardizohet e të kritikohet gjithëçka këtu.

Alban Krasniqi: Neni i 35-të i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale. 35.1 Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjedhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi Zgjedhjet Lokale. Me këtë e mbylli debatin se kush është organi më i lartë këtu dhe kush ka kompetenca më të mëdha.

Ne jemi këtu që t'i trajtojmë problemet e qytetarëve e që janë të shumta. Ne jemi gjithashtu këtu që veprimet e Kryetarit që nuk janë të këqija duhet që të shkojnë sipas procedurave dhe rregullave.

Arbëreshë Krasniqi: E dëgjova Bacin Ilaz për rastin që paraqiti këtu dhe është mirë që Kryetari ta trajtoj rastin e Zenel Thaqit sepse ka nevojë.

Unë pajtohem me fajlimin e profesoreshës Hidajete për sundjen e kancerit. E di që janë drejtuar shumë kërkesa në drejtim të Kryetarit për këtë rast dhe e di që në anën tjetër nuk kemi shumë mundësi ndihem, por është mirë që të identifikohen rastet e tilla dhe si unë personlisht t'i drejtohem Ministrisë së Shëndetësisë për ndonjë mbështetje. Kryetar shuma nga 200€ për këto raste të rritet edhe më shumë sepse kjo smundje ka shpenzime të shtrejta.

Propozimet që paraqiti Albani janë të pabazuara dhe nuk e ndihmojnë procesin por vetëm bëjnë amulli dhe propozoj që këto propozime të kthehen në rekomandime edhe për Kryetarin dhe stafin e tij dhe të mos humbim në si Kuvend kuptimin e punës dhe të bërit politikë këtu.

Alban Mazreku: Pajtohem që atë që kërkuam për marrjen e një vendimi të shtyhet për mbledhjen tjetër sepse duhet të konsultohemi me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Propozoj që pikat e rendit të ditës që janë kërkesa për ndërrim dhe destinim të tokës bujqësore në atë ndërtimore të diskutohen menjëherë pas kësaj si dhe pika për formimin e komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit.

Rrahim Morina: Sipas propozimit të Alban Mazrekut a po pajtoheni që t'i diskutojmë këto pika të rendit të ditës e të tjerat të shtyhen për një mbledhje tjetër?

Për: unanimisht

Kryetari- Ragip Begaj: Është mirë që kur të diskutohet për ridestinimin e pronave të shikohen pak gjërat. Një rast i ëhstë nxën dera AKP-së "Mirusha" sepse diksuh e ka blerë pronën dhe i është nxën dera.

Rrahim Morina: Atëherë kalojmë në pikën e 15-të: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/442 datë: 05.11.2018 e parashtruar nga Ramiz X.Thaqi nga fshati Mirushë për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Sa i përketë debait a shkojmë në cilësin e shefave të grupeve? E hapi debatin. Nëse s'ka debat atëherë kush është pro kësaj kërkesë?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 1

Kalojmë në pikën e 16-të: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/463 datë: 12.11.2018 e parashtruar nga Faik Hoti nga Malisheva për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. Kush është pro kësaj kërkesë?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 1

Kalojmë në pikën e 17-të: Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr.02/446 i dt: 05.11.2018 e parashtruar nga Milazim Dukolli nga fshati Bubavec për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore. (Sylë Dukolli del nga salla dhe nuk merr pjesë në votim për çështje konflikt interesi) Kush është për?

Për: 20

Kundër: 0

Abstenim: 1

Alban Krasniqi nuk merr pjesë në asnjërin votim për këto kërkesa

Kalojmë në pikën e 12-të sipas nr. të renditjes në rendin e ditës: Formimi i Komisionit për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019. Në praktikën e mëhershme kanë marrë pjesë veç shefat e grupeve dhe e kanë bërë Planin e Punës së Kuvendit nëse doni të ndryshoni diçka urdhëroni, nëse jo shkojmë sipas praktikës. A po pajtoheni që pjesë e këtij komisioni të jenë shefat e grupve politike dhe Zyra e Kryetarit? Kush është për?

Për: 21 (unanimisht)

Me votim unanim konstatohet që është formuar Komisioni për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2019.

Kalojmë në pikën e 14-të të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Tatimin në Pronë për vitin 2019. Drejtor, keni fjalën.

Valon Mazreku: Ne e kemi dhënë një propozim për Rregulloren për Tatim në Pronë që është në harmoni me ligjin e financave dhe Departamentin e Tatimit në Pronë sepse ata e bëjnë edhe vlerësimin e pronave. Kjo Rregullore është e mbështetur në ligjin 03L/204 dhe 06L/005 për Tatimin në Pronë e Palujtshme, neni 9.1 si dhe ligjit 03L/040 për Vetëqeverisjen Lokale.

Sipas ligjit 06L/005 në vitin 2019 ka për t'u tatimuar 20% e pronës, dhe nga viti në vit do të rritet përqindja deri 5 vitet ku do të tatimohet 100% i tokës në përgjithësi.

Sipas kësaj Rregullore të neni 1, fjala është për bazën tatimore në bazë të të cilave llogariten edhe normat tatimore ku janë të përcaktuara zonat tatimore dhe nivelet e vlerave për m² në K. e Malishevës. Normat janë të dy niveleve: niveli minimal 0.15% dhe ai maksimal deri në 1% dhe mbrenda rregullores është e sqaruar kjo.

Rregulloren e ka përgaditur Menaxheri i Tatimit në Pronë dhe ai është kompetent për këtë punë. Ju e keni materialin dhe po ju la hapësirë për debat dhe çfarë do që keni më tuje, unë jam këtu për sqarime.

Alban Mazreku: Drejtor, te neni 2.1, zona e parë tatimore përfshinë banesat, shtëpitë dhe lokalet afariste të cilat gjenden për skaj të rrugës "Adem Jashari", "Gjergj Kastrioti-Skenderbeu", "Imer Krasniqi" dhe "Ibrahim Mazreku" deri ku përfundo rruga apo deri ku përfundon zona e Malishevës?

Alban Krasniqi: A ka ndonjë dokument që Ministria e përcakton zonën e parë atë çështjen që ngriti Albani? Si kanë ardhur këto eërtime-hapësira? 200 metershi a është vi e drejtë për skaj rrugës apo si?

Avni Krasniqi: Pershendetje për të gjithë! Kjo Rregullore që po diskutohet sot do sqarim vetëm për përcaktimin e normës tatimore dhe jo çështjen e vlerësimit. Çështjen e vlerësimit më nuk e keni ju në kompetencë sepse është çështje e mbyllur dhe përsëritet e njëjta gjendje ashtu siç ka qenë deri më tani. Zona e parë tatimore fillon prej rrugës kryesore 200 metra në të dy anët e rrugës. Zona e parë dhe dytë janë në Malishevë.

Alban Krasniqi: Rregulloreja duhet të kalojë nëpër procedura në lexim të parë të dytë, debat publik dhe sot në parim po e mbështesim me kushtin që të sqarohet mirë ajo çështja e zonave që kërkoj Albani dhe unë.

Te neni 3, ku përmendet 0.15% të përmendet që është minimumi dhe të gjitha elementet e kësaj rregullore të jenë mbrenda saj.

Valon Mazreku: Unë në fillim e ceka që minimumi është 0.15% dhe maksimumi është 1%. Ndoshta është e drejtë që të shenohet te neni 3 te norma tatimore si paragraf.

Përgjatë zonës kadastrale të Malishevës 200m në anën e majtë dhe 200m në anën e djathtë është zona e parë, pastaj nga ty fillon zona e dytë për 200m të tjerë e kështu me rradhë që në rregullore i keni të specifikuar se cilat fshatra hyjnë në zonën e treë dhe cilët në zonën e katër.

Rrahim Morina: Pas debatit dhe sqarimeve të drejtorit e hudhi në votim. Kush është pro kësaj rregullore në leximin e parë?

Për: 24 (uananimisht)

Kërkoj nda Drejtoria e Financave që sa më parë të organizoj debat publik për këtë rregullore e që në mbledhjen tjetër sa më shpejtë ta aprovojme.

Arbëreshë Krasniqi: Sinan Gegaj më delegoi si Këshlitare e Asamblesë Komunale në Malishevë pasi që Kuvendi Komunal ka vendosur unanimitisht për emerimin e stadiumit "Liman Gegaj" e Limani ishte vëlla i Sinanit ai ju fton që të merrni pjesë nesër në përrurimin e stadiumit dhe pas përrurimit ju ka ftuar për kafe.

Rrahim Morina: Falemnderit për pjesëmarrje, me kaq mbledhjen e shpalli të mbyllur shihemi në mbledhjen tjetër!

Mbledhja përfundoi në ora 16.

Procesmbajtësja: Samirë Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit: Rrahim Morina